




REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova – Republic of Kosovo



KOMUNA E MITROVICËS JUGORE
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria Komunale e Arsimit

Nr. Protokoli 07-610/01-0035361/26 dt. 19-06-2026

Në bazë të nenit 62 paragrafi 3 të Ligjit nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 84, të Statutit të Komunës Nr.02-060/01-0056607/20-4 dt.24.09.2020, si dhe duke u bazuar në ligjet që rregullojnë fushën e Arsimit Parauniversitar në Republikës së Kosovës (Ligji nr. 02/L-52, Ligji nr.03/L-068, Ligji nr.04/L-32 dhe Ligji nr.04/L-138), dhe me qëllim të mënjanim të subjektivizimit, joprofesionalizimit dhe familjarizimit me rastin e pranim të fëmijëve në Institucionin Parashkollor (IP) Publik në Komunën e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA) merr këtë:

V E N D I M

(për kriteret e pranim të fëmijëve në Institucione Parashkollore Publike)

1. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të Komunës së Mitrovicës mund të regjistrohen në institucionet parashkollore (IP), të Komunës së Mitrovicës.
2. Planifikimin për numrin e fëmijëve që do të pranohen në IP e bëjnë vetë IP-të, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të IP-ve.
3. Moshë minimale e fëmijëve dhe grup moshave që do të pranohen në Institucion Parashkollor e përcakton vetë Institucioni Parashkollor, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore të Institucionit Parashkollor, por llogaritja e moshës së fëmijëve nuk bëhet duke marr parasysh datën e regjistrimit por datën e fillimit të shërbimit, përkatësisht duke marr parasysh **datën 1 shtator**.
4. Pranimi i fëmijëve në Institucionet Parashkollore bëhet në bazë të numrit të madh të pikëve totale që merr një kandidat duke u bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoria	pikë
1	Fëmijët bonjakë pa të dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjakë pa një prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
3	Fëmijët bonjakë pa një prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar	80
4	Fëmijët e invalidëve të UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	40
5	Fëmijët e invalidëve të UÇK-së nëse njëri prind është i punësuar	30
6	Fëmijët e invalidëve të UÇK-së nëse asnjëri prind nuk është i punësuar	20
7	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse të dy prindërit janë të punësuar	80
8	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse njëri prind është i punësuar	60



9	Fëmijët me nevoja të veçanta nëse asnjëri prind nuk është i punësuar	40
10	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
11	Fëmijët e prindërve të divorcuar nëse prindi kujdestar nuk është i punësuar	30
12	Fëmijët e veteranëve të UÇK-së nëse të dy prindërit punojnë	20
13	Fëmijët e veteranëve të UÇK-së nëse njëri prind punon	15
14	Fëmijët e veteranëve të UÇK-së nëse asnjëri prind nuk është i punësuar	10
15	Fëmijët e personelit të IP-së	80
16	Fëmijët me dy prindër të punësuar me të ardhura me të ulta.	50
17	Fëmijët me një prindër të punësuar (nëna) me të ardhura me të ulta	60
18	Fëmijët me dy prindër të punësuar me të ardhura mesatare	40
19	Fëmijët me një prind të punësuar (nëna) me të ardhura mesataret	30
20	Fëmijët e prindërve që e kanë një fëmijë në vijueshmëri	30

5. Të gjitha statutet e të gjitha kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmohen me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



T'i dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Drejtorisë Komunale të Arsimit
- 1x1 Institucionit Parashkollor
- 1x1 Arkivit

